



# USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 1 (827752)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 7 Janar 2022

## Pritet me interes fushata e rekrutimeve për ushtarë/detarë edhe në Korçë



### Ministri Peleshi: Të jesh efektiv i FA është nder, sepse përfaqëson një vend anëtar të NATO-s

Fillimi i vitit të ri 2022 e gjeti ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi në qytetin e Korçës nga ku së bashku me përfaqësues të Forcave të Armatosura ndoqi procesin e rekrutimit të të rinjve dhe të rejave, nga ku ftoi ta konsiderojnë këtë një nga mundësitë më të mira për karrierën e tyre: "Ne duam të ftojme, jo vetëm me thirrje

patriotike, të rinjtë për t'u bërë pjesë e FA, por marrim përsipër edhe përgjegjësitë tona për t'i dhënë sa më shumë dinjitet këtij pozicioni. Të jesh ushtarak, të jesh efektiv i FA-së është një nder, një krenari e madhe, sepse përfaqëson të gjithë forcën e kombit, përfaqëson një vend që është anëtar i NATO-s. Pra... >>> faqe 2

## Ceremonia

### Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Kundëradmiral Adnan Agastra, garancia për konsolidimin e arritjeve



>>> faqe 4

# Komanda e Operacioneve Speciale në Europë Ministri Niko Peleshi: I lumtur për këtë vendim të jashtëzakonshëm të SHBA

Shqipëria çdo ditë e më tepër faktor i paqes dhe stabilitetit në rajon, përkrah partnerëve tanë strategjikë SHBA dhe aleancës së NATO-s >>> faqe 3



**SOCEUR**  
U.S. Special Operations Command Europe

## Kontingjenti i 9-të EOD

Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Përkushtimi juaj për t'i shërbyer vendit në vijën e parë të frontit të Aleancës, krenari për FA

Në Batalionin e Xhenios më 6 janar 2022, u zhvillua ceremonia e kthimit të Kontingjentit të 9-të EOD nga misioni në Letoni. Në këtë ceremoni mori pjesë dhe përshëndeti në emër të SHP, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu. Ishin të pranishëm edhe shefi i Shtabit të Komandës së Mbështetjes, kolonel Shkëlqim Çela...



>>> faqe 5

## Speciale

### Liderët që shënjuan histori në rrugëtimin e gjatë të Forcave të Armatosura

Mehmet pashë Deralla, u lind në vitin 1843, në Gradec të kazasë së Tetovës, i biri i Hasan pashë Derallës, familja e tyre ishte fort e njohur dhe me ndikim të madh në krahinë. U arsimua në Shkup, Manastir dhe institutet ushtarake në Stamboll. Më 1878, familjarët e tij morën pjesë në mbledhjen e Prizrenit si delegatë...

>>> faqe 6-7



Jens Stoltenberg

## Koncepti Strategjik i NATO-s

>>> faqe 8-9

## MESAZHI

Gjeneralmajor Begaj: Viti 2022 na gjen besimplotë për realizimin e objektivave dhe detyrave tona

faqe 2

## KËNGË ME VARGJE EMOCIONUESE PËR FA

Kryeministri Edi Rama: Ftesë për t'iu bashkuar

faqe 5

Pritet me interes fushata e rekrutimeve për ushtarë/detarë edhe në Korçë

**F**illimi i vitit të ri 2022 e gjeti ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi në qytetin e Korçës nga ku së bashku me përfaqësues të Forcave të Armatosura ndoqi procesin e rekrutimit të të rinjve dhe të rejave, nga ku ftoi ta konsiderojnë këtë një nga mundësitë më të mira për karrierën e tyre: “Ne duam të ftojme, jo vetëm me thirrje patriotike, të rinjtë për t’u bërë pjesë e FA, por marrim përsipër edhe përgjegjësitë tona për t’i dhënë sa më shumë dinjitet këtij pozicioni. Të jesh ushtarak, të jesh efektiv i FA-së është një nder, një krenari e madhe, sepse përfaqëson të gjithë forcën e kombit, përfaqëson një vend që është anëtar i NATO-s. Pra, çdo i ri që nesër do të bëhet pjesë e FA-ve duhet të ketë parasysh që bëhet anëtar i FA-ve, që janë pjesë e aleancës së NATO-s”, - u shpreh gjatë këtij aktiviteti ministri Peleshi.

Z. Peleshi bëri të ditur se të gjithë ata të rinj që nesër do të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura, si rezultat i këtij procesi rekrutimi do të vlerësohen nga një sistem pagash që janë ndër më të lartat në rajon. Ministri Peleshi tha se qeveria shqiptare e bën këtë për t’i treguar Ale-

# Ministri Peleshi: Të jesh efektiv i FA është nder, sepse përfaqëson një vend anëtar të NATO-s

*“Të gjithë ata të rinj që nesër do të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura, si rezultat i këtij procesi rekrutimi do të vlerësohen nga një sistem pagash që janë ndër më të lartat në rajon”*



ancës se Shqipëria meriton të jetë anëtare e NATO-s, por edhe për të treguar ambicien për të qenë të krahasueshëm me vendet e tjera anëtare të kësaj aleance.

Teksa përsëriti ftesën për të rinjtë e të rejtat ai theksoi se FA krijon hapësira të mëdha karriere: “Kam një ftesë për të rinjtë dhe të rejtat, ta konsiderojnë realisht, jo sepse kështu më takon mua pozicioni të them, por sepse realisht të fillosh një karrierë në FA është një mundësi e pakrahasueshme me shumë karriera të tjera, sepse së pari fillon me një pagë mbi 50 e ca mijë lekë të reja, pra mbi 500 mijë lekë të vjetra e thënë thjesht, pavarësisht arsimit

që ke. Në rast se ke arsim të lartë hapen dyer shumë të mëdha përmes kurseve në vendet e NATO-s, në Shqipëri, në Akademinë e Forcave të Armatosura ti mund të rritesh në karrierë, mund të arrish edhe gradat më të larta, pse jo, por edhe në rast se ke një arsim më modest, një arsim të mesëm, përsëri ke mundësi të futesh në sistemin e gradimeve”, - shpjegoi ministri Peleshi.

Fushata e rekrutimeve do të zgjasë deri më 20 janar dhe këtë herë ka një specifikë. Për ta bërë më të lehtë qasjen e të rinjve, në çdo qendër qyteti janë ngritur pika të veçanta, duke mos e kufizuar këtë proces vetëm në qendrat e rekrutimit.

Mesazhi i gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj, shëf i Shtabit të Përgjithshëm, për Vitin e Ri

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj iu uron një fillim viti të mbarë të gjithë personelit ushtarak dhe civil që shërbejnë në Forcat e Armatosura: Të dashur ushtarë, nënoficerë, oficerë dhe civilë të Forcave të Armatosura!

Gjej rastin të falënderoj burrat dhe gratë në uniformë dhe personelin civil të Forcave të Armatosura për angazhimin, përkushtimin, në përbjeksjet dhe sakrificat e bëra në shërbim të Atdheut dhe Aleancës së Atlantikut të Veriut gjatë vitit 2021.

Me gjithë vështirësitë e krijuara nga situata pandemike, intensiteti dhe dinamika e aktiviteteve dhe angazhimeve tona ka qenë e vazhdueshme dhe maksimale. Në çdo ditë dhe kohë nevojë gjatë vitit që kaluam. Forcat e Armatosura kanë qenë pranë komuniteteve për shuarjen e zjarreve, në përbalimin e përmbajtjeve si dhe për çdo emergjencë tjetër. Si gjithmonë, ne kemi qenë dhe do të jemi aty ku ka pasur nevojë vendi, aty ku na ka kërkuar populli, aty ku na ka thirrur detyra. Aktiviteti i përgatitjes dhe stërvitjes së përditshme ka qenë një nga sukseset e vitit, duke u finalizuar me kontributin e veçantë në stërvitjen e madhe me aleatët e NATO-s, “Defender Europe - 21”.

Angazhimi dhe kontributi i Forcave të Armatosura për paqen dhe sigurinë,

## Gjeneralmajor Begaj: Viti 2022 na gjen besimplotë për realizimin e objektivave dhe detyrave tona

*“Mbështetje të plotë dhe të sigurt të qeverisë dhe aleatëve tanë”*



përmes pjesëmarrjes në misionet e NATO-s, Bashkimit Evropian, Kombeve të Bashkuara dhe iniciativave rajonale, e kanë rritur më tej rolin e Shqipërisë si faktor i vlerësuar për fqinjët, rajonin, por edhe botën. Këtë vit, Forcat tona të

Armatosura, mbyllën me sukses, faqebardhë dhe dinjitet, një nga misionet më të gjata, të vështira dhe të rrezikshme, sikurse ishte angazhimi në Afganistan.

Ndërkohë, viti 2022 vjen me detyrime të reja, sfida të parashikuara, por

edhe të paparashikuara. Ne i njohim vështirësitë dhe do t’i sfidojmë ato! Ne jemi besimplotë se do t’i realizojmë objektivat dhe detyrat tona! Këtë e garanton përkushtimi dhe profesionalizmi juaj, mbështetja e plotë dhe e

sigurt e qeverisë dhe aleatëve tanë, të cilët unë gjej rastin t’i falënderoj për mbështetjen që po i japin Forcave të Armatosura.

Forcat e Armatosura kanë nevojë të përmirësojnë dhe rrisin kapacitetet e tyre operacionale. Për vitin 2022, kryefjala do të jetë motivimi, edukimi dhe përgatitja e personelit, përmirësimi i kushteve të jetesës, modernizimi dhe vijimi i angazhimeve dhe kontributit në misionet brenda dhe jashtë vendit. Kjo është dhe do të mbetet një nga prioritetet e mia kryesore.

Vlerësimet më të larta individualisht për çdo pjesëtar të Forcave të Armatosura për gjithçka keni bërë gjatë këtij viti në realizim të misionit tonë. Sigurisht ju meritoni edhe më shumë dhe viti i ri do të përmbushë shumë pritshmëritë tona kolektive dhe individuale.

Në këtë vit të ri shpreh urimet më të mira për gjithë personelin e Forcave të Armatosura dhe familjet e tyre. Një urim të veçantë përcjell për të gjitha vajzat dhe djemtë, burrat dhe gratë me uniformë, që ndodhen në krye të detyrës brenda dhe jashtë vendit.

*Shëndet dhe suksese në 2022!  
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH  
Gjeneralmajor,  
Prof. Asoc. Bajram Begaj*

**K**omanda e Operacioneve Speciale në Europë (SOCEUR) njoftoi se një shtab pararojë do të ngrihet në Shqipëri, me rotacion. Selia e re u bë e mundur falë mbështetjes së jashtëzakonshme të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për rritjen e aftësive të Forcave të Operacioneve Speciale, si një gur themeli për stabilitetin rajonal.

Vendndodhja e selisë në Shqipëri do të sigurojë ndërveprueshmëri më të madhe me aleatët tanë shqiptarë, qasje të rëndësishme në qendrat e transportit në Ballkan dhe fleksibilitet më të madh logjistik.

Shqipëria mbetet një aleate e fortë e NATO-s dhe SHBA-të gëzojnë një marrëdhënie të fortë me qeverinë dhe Ministrinë e Mbrojtjes të Shqipërisë, gjë që e bën vendosjen e një shtabi pararojë në këtë vend aleat, një vendim të natyrshëm. Gjithashtu, kjo vendndodhje redukton në masë të madhe kohën e udhëtimit dhe rrit fleksibilitetin e operacioneve speciale dhe forcave konvencionale në rajon. Kjo nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e jashtëzakonshme të qeverisë shqiptare dhe profesionalizmin e ushtrisë shqiptare.

“Aftësia për të lëvizur dhe trajnuar me shpejtësi brenda Ballkanit, në bashkëpunim të ngushtë me forcat e tjera aleate dhe partnere, e bëri Shqipërinë vendndodhjen më të mirë për këtë përpjekje”, -tha generalmajor David H. Tabor, komandant i Komandës së Operacioneve Speciale në Europë. “Shqipëria mbetet një aleate e rëndësishme e NATO-s dhe një partnere e çmuar e sigurisë, si në nivel rajonal ashtu dhe global”, -shtoi ai.

SOCEUR luan një rol të rëndësishëm për të demonstruar përkushtimin e SHBA-së ndaj aleatëve dhe partnerëve tanë në Ballkan dhe kjo përpjekje po kryhet me mbështetjen e plotë të qeverisë shqiptare dhe përfaqëson vlerësimin për profesionalizmin e ushtrisë shqiptare. Nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme dhe bashkëpunimit të ngushtë, Forcat e Operacioneve Speciale të SHBA-së sigurojnë një lidhje të rëndësishme midis aleatëve dhe partnerëve tanë në rajon, duke rritur kështu stabilitetin rajonal. SOCEUR ka një pozicion unik për të stimuluar marrëdhënien tonë me aleatët dhe partnerët për t’iu kundërvënë ndikimeve keqdashëse, për të ndërtuar ndërveprueshmërinë, për t’iu përgjigjur me shpejtësi kërcënimeve që mund të lindin dhe nëse është e nevojshme, për të mposhtur sulme. Në një reagim në “facebook” ministri Peleshi shkruan: “I lumtur për këtë vendimin të jashtëzakonshëm të Komandës së Operacioneve Speciale në Europë (SOCEUR). Shqipëria çdo ditë e më tepër faktor i paqes dhe stabilitetit në rajon, përkrah partnerëve tanë strategjikë SHBA dhe aleancës së NATO”.



## Komanda e Operacioneve Speciale në Europë

# Ministri Niko Peleshi: I lumtur për këtë vendim të jashtëzakonshëm të SHBA

*Shqipëria çdo ditë e më tepër faktor i paqes dhe stabilitetit në rajon, përkrah partnerëve tanë strategjikë SHBA dhe aleancës së NATO-s*



### Ambasadorja amerikane Yuri Kim

*Komanda e Operacioneve Speciale në Evropë ka njoftuar se ka vendosur që të ngrejë në Shqipëri një shtab bazë të Forcave të Operacioneve Speciale, me rotacion. Ambasadorja amerikane Yuri Kim, në një postim në llogarinë e saj në “Twitter” shprehet, se kjo është një mënyrë shumë e mirë për të nisur vitin sa i përket zhvillimit të mëtejshëm të marrëdhënieve Shqipëri-SHBA, në aspektin e mbrojtjes.*



**SOCEUR luan një rol të rëndësishëm për të demonstruar përkushtimin e SHBA-së ndaj aleatëve dhe partnerëve tanë në Ballkan dhe kjo përpjekje po kryhet me mbështetjen e plotë të qeverisë shqiptare dhe përfaqëson vlerësimin për profesionalizmin e ushtrisë shqiptare. Nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme dhe bashkëpunimit të ngushtë, Forcat e Operacioneve Speciale të SHBA-së sigurojnë një lidhje të rëndësishme midis aleatëve dhe partnerëve tanë në rajon, duke rritur kështu stabilitetin rajonal.**

### Kryeministri Edi Rama

*Kryeministri Edi Rama shkruan në faqen e tij në “facebook”; SUPERLAJM Komanda Amerikane e Operacioneve Speciale për Europën do të ngrejë Shtabin e saj Pararojë në Shqipëri.*



Kundëradmiral Adnan Agastra mori zyrtarisht detyrën e komandantit të Forcës Detare

# Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Kundëradmiral Adnan Agastra, garancia për konsolidimin e arritjeve

*Mirënjohje për gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, profesionalizmi dhe shërbimi i të cilit do të jetë i domosdoshëm në detyra të tjera të karrierës ushtarake*

**K**undëradmiral Adnan Agastra mori zyrtarisht detyrën e komandantit të Forcës Detare. Në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua ceremonia e marjes së detyrës të Kundëradmiral Adnan Agastra. Kundëradmiral Adnan Agastra, Komandanti i ri i Forcës Detare, është një nga ushtarakët më të spikatur të Forcave tona të Armatosura, me integritetin dhe përgjegjshmërinë e tij do konsolidojë më tej arritjet e Forcës sonë Detare.

Mirënjohje për gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, profesionalizmi dhe shërbimi i të cilit do të jetë i domosdoshëm në detyra të tjera të karrierës ushtarake dhe suksese komandantit të ri të Forcës Detare.

Në ceremoni morën pjesë: ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandantët e forcave si dhe ushtarakë të FD.

Detyra iu dorëzua kundëradmiral Agastrës nga paraardhësi i tij gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, i cili i dorëzoi edhe flamurin luftarak të Forcës Detare.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi falënderoi gjeneral brigade Xhebexhian për kontributin e tij të deritanishëm në krye të Forcës Detare dhe shprehu bindjen se komandanti i ri ka të gjitha aftësitë për t'i çuar më tej arritjet në këtë forcë. "Duke e uruar gjeneral brigade Xhebexhin për një vijim të suksesshëm në detyra të tjera të karrierës ushtarake, shpreh bindjen se ai ndjehet i nderuar edhe që stafetën ia lë një prej profesionistëve të spikatur dhe me ambicie të larta për të bërë më të mirën, siç është kundëradmiral Agastra. Me një karrierë të gjatë dhe dinjitoze, me një angazhim, eksperiencë dhe kontribut pothuajse në çdo fushë dhe nivel të aktivitetit të FA në përgjithësi, dhe të Forcës Detare në veçanti, brenda dhe jashtë vendit, kundëradmiral Agastra, është siguria dhe garancia e të gjithëve për konsolidimin e arritjeve, progres të mëtejshëm dhe realizim të detyrave."

Ministri Peleshi foli edhe për avantazhet që premtion buxheti i rritur i Mbrojtjes, si në modernizimin e FA ashtu edhe në trajtimin financiar të ushtarakëve: "Do të jetë një vit me shumë sfida. Natyrisht kemi një buxhet 32% më të lartë sesa buxheti i vitit të kaluar, kemi 65% më shumë buxhet për modernizimin e FA, kemi një sistem pagash për këtë vit të planifikuar në buxhet prej 30% më shumë në të gjithë nivelet nga ushtari bazë deri te gjenerali, që do të thotë edhe në pjesën materiale përveç asaj morale dhe do t'i japin më shumë motiv të rinjve, të rejave edhe të gjithë efektive të FA për të kontribuar."

Edhe komandanti i ri, kundëradmiral Agastra e vendosi theksin te modernizimi i FD, i cili siç tha ai, synon rritjen e kapaciteteve të anijeve luftarake të flotës sonë, jo vetëm si një domosdoshmëri e rritjes së sigurisë kombëtare, por edhe kontributit në Aleancë.

Kundëradmiral Adnan Agastra, me propozim të ministrit të Mbrojtjes, u emërua komandant i Forcës Detare me dekret të presidentit të Republikës, duke u bërë komandanti i 19-të i flotës detare shqiptare.



*Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi falënderoi gjeneral brigade Xhebexhian për kontributin e tij të deritanishëm në krye të Forcës Detare dhe shprehu bindjen se komandanti i ri ka të gjitha aftësitë për t'i çuar më tej arritjet në këtë forcë. "Duke e uruar gjeneral brigade Xhebexhin për një vijim të suksesshëm në detyra të tjera të karrierës ushtarake, shpreh bindjen se ai ndjehet i nderuar edhe që stafetën ia lë një prej profesionistëve të spikatur dhe me ambicie të larta për të bërë më të mirën, siç është kundëradmiral Agastra."*



ARTISTËT BASHKOJNË FORCAT DHE KRIJOJNË KËNGËN ME VARGJET EMOCIUNUESE PËR FA

# Kryeministri Rama: Ftesë për t'iu bashkuar

“**F**luturoj, qiellin tim unë e mbroj. Dashurinë, që kjo tokë ma mëkoi. Unë e fal gjakun tim kur vlon, e më thotë ti je shqiptar.”, me një zë, dedikuar Forcave të Armatosura të vendit tonë, Elton Deda, Redon Makashi, Eneda Tarifa dhe Saimir Braho bashkuan forcat për këtë këngë.

Këngëtarët Elton Deda, Redon Makashi dhe Saimir Braho janë specialistë në sektorin e Kulturës dhe Sportit në Qendrën e Kulturës, Medies, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të FA.

Kryeministri Edi Rama ka publikuar videoklipin, duke shtu-

ar se kjo është edhe një ftesë për t'iu bashkuar Forcave të Armatosura.

“Mirëmëngjesi dhe me një videoklip të pazakonshëm, si ftesë për t'iu bashkuar Forcave tona të Armatosura, ju uroj një ditë të mbarë.”, -shkroi kryeministri në rrjetin social, më 7 janar 2022.

Videoklipi u promovua më herët nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi me rastin e festave të fundvitit, më 31 dhjetor 2021, si dhe në kuadër të fushatës së rekrutimeve për t'u bërë pjesë e FA, me sloganin “Ti ke Forcën që nderon Kombën”.



## Ceremonia e kthimit të Kontingjentit të 9-të EOD nga misioni në Letoni

# Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: Përkushtimi juaj për t'i shërbyer vendit në vijën e parë të frontit të Aleancës, krenari për Forcat e Armatosura

**N**ë Batalionin e Xhenios më 6 janar 2022, u zhvillua ceremonia e kthimit të Kontingjentit të 9-të EOD nga misioni në Letoni. Në këtë ceremoni mori pjesë dhe përshëndeti në emër të SHP, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu. Ishin të pranishëm edhe shefi i Shtabit të Komandës së Mbështetjes, kolonel Shkëlqim Çela. Fjalën e rastit e mbajti komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Hajdar Gurra.

Në fjalën e saj gjeneralmajor Manushaqe Shehu do të shprehej:

I nderuar zoti shef i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Çela!

I nderuar zoti komandant i Batalionit, kolonel GURRA!

Të nderuar efektivë të Kontingjentit të 9-të, të Misionit të Aleancës në Letoni!

Të nderuar pjesëmarrës!

Është kënaqësi që e fillojmë këtë vit me takime për raste të tilla të gëzuara. Ndjem e privilegjuar t'i uroj efektivit të Kontingjentit të 9-të të misionit të Prezencës së Përparuar të Përforcuar të NATO-s në Letoni, mirëseardhjen në atdhe, pranë familjeve, njerëzve të dashur dhe kolegëve të tyre. Kënaqësi që ju shikojmë të gjithëve mirë dhe që e festuat ndërrimin e viteve pranë familjeve tuaja!

Në emër të autoriteteve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, ju shpreh falënderimet dhe vlerësimet tona më të mira për kryerjen me profesionalizëm, nder dhe dinjitet të detyrës tuaj fisnike, pavarësisht kufizimeve dhe vështirësive të situatës pandemike.

Përkushtimi juaj për t'i shërbyer vendit në vijën e parë të frontit të Aleancës, që gjithmonë e më shumë duket se po bëhet një vijë kritike, është krenari dhe lavdi për ju, për familjet tuaja dhe për gjithë Forcat e Armatosura.



Ne gjithmonë e kemi pasur dhe e kemi të sigurt suksesin në këtë mision, sepse kemi bindje dhe besim të plotë në përgjegjësinë, përkushtimin dhe profesionalizmin e efektivëve si ju.

Ju, ashtu sikurse edhe kolegët tuaj të kontingjenteve paraardhëse në këtë mision të rëndësishëm, me aftësitë, shërbimin, kontributin, por edhe me sakrificën sublime, keni treguar vlera dhe keni fituar respektin e besimin e plotë të koman-



duesve e drejtuesve kanadezë të këtij misioni, kolegëve tuaj të Aleancës dhe të partnerëve tanë atje. Kjo është një krenari dhe dinjitet i shtuar për të gjithë ne, Forcat e Armatosura dhe për vendin.

Pas përfundimit dhe mbylljes me sukses e nder të plotë të kontributeve tona në misionet e vështira të Afganistanit, misioni i Prezencës së Përparuar të Përforcuar të NATO-s në Letoni, ngelet një nga angazhimet tona kryesore euro-atlantike në kuadër të Aleancës.

Për këtë arsye, ky mision ka dhe do të ketë një vëmendje dhe mbështetje të veçantë të autoriteteve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm. Pjesë dhe vlerë e rëndësishme, jetike dhe organike e kësaj vëmendje është edhe mbështetja, bashkëpunimi dhe durimi i familjeve tuaja gjatë shërbimit tuaj në këtë mision. Prandaj, asnjëherë nuk do të jetë e tepërt të shprehim falënderimet, mirënjohjen dhe respektin për familjet tuaja, për familjet e gjithë ushtarakëve, për mirëkuptimin që tregojnë dhe sakrificën që bëjnë në këto raste.

Duke ju përshëndetur dhe falënderuar edhe njëherë për përbushjen me sukses të detyrave tuaja në mision, ju uroj një rikthim të mirëpritur në detyrat dhe shërbimin tuaj të zakonshëm ushtarak dhe një vit të mbarë për ju dhe familjet tuaja!

Ju faleminderit!





MSC. MIMOZA GOLIKJA

# Koncepti Strategjik i NATO-s

*Jens Stoltenberg: “Koncepti Strategjik i Madridit do të pasqyrojë mjedisin e ri të sigurisë, do të ripërkushtohet ndaj vlerave tona dhe do të riafirmojë unitetin tonë, duke siguruar që Aleanca jonë të jetë e përshtatshme për të ardhmen”*

**N**ATO njofton, në faqen zyrtare, se do të miratojë Konceptin e saj të ri Strategjik në Samitin e Madridit 2022. Ky koncept do të përcaktojë sfidat e sigurisë me të cilat përballet Aleanca dhe do të përshkruajë detyrat politike dhe ushtarake që NATO do të kryejë për t'i trajtuar ato.

## Çfarë është Koncepti Strategjik i NATO-s?

Koncepti Strategjik është një dokument kyç për Aleancën. Ai ripohon vlerat dhe qëllimin e NATO-s dhe ofron një vlerësim kolektiv të mjedisit të sigurisë. Ai gjithashtu drejton përshtatjen strategjike të NATO-s dhe drejton zhvillimin e saj të ardhshëm politik dhe ushtarak. Politikisht, Koncepti Strategjik zë vendin e dytë pas Traktatit të Uashingtonit, i cili përbën bazën e Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut. Koncepti Strategjik rishikohet dhe përditësohet rregullisht.

Që nga fundi i Luftës së Ftohtë, ai është përditësuar afërsisht çdo 10 vjet, me qëllim për të marrë parasysh ndryshimet në mjedisin global të sigurisë dhe për t'u siguruar që Aleanca është e përgatitur për të ardhmen. Bota ka ndryshuar rrënjësisht në dekadën e fundit dhe konkurrenca strategjike po rritet, “kështu që ka ardhur koha për të përditësuar Konceptin Strategjik”. Koncepti i fundit Strategjik u miratua në Samitin e Lisbonës në 2010 dhe koncepti i ri do të bazohet në elemente të Konceptit 2010 që janë ende relevante. Në Samitin e Brukselit në qershor 2021, udhëheqësit e NATO-s ranë dakord të zhvillonin Konceptin e ardhshëm Strategjik, tashmë në kohën e duhur, në Samitin e Madridit në qershor 2022.

## Si do të krijohet Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s?

Në Samitin e Brukselit të vitit 2021, liderët e NATO-s i kërkuan Sekretarit të Përgjithshëm Jens Stoltenberg të udhëheqë procesin e zhvillimit të Konceptit të ardhshëm Strategjik. Sekretari i Përgjithshëm ka iniciuar një fazë konsultimesh të brendshme dhe të jashtme. Konsultimet e brendshme po kryhen me aleatët mbi mjedisin strategjik në zhvillim, qasjen dhe prioritetet e NATO-s. Katër seminare po organizohen në kryeqytetet aleate për të bashkuar udhëheqjen e NATO-s, zyrtarët dhe komunitetet e ekspertëve. NATO po angazhohet gjithashtu me partnerë, organizata të tjera ndërkombëtare dhe me komunitetet e ekspertëve, organizatat rinore, shoqërinë civile dhe sektorin privat. Pas kësaj faze konsultimi, aleatët do të negociojnë dhe bien dakord për Konceptin e ardhshëm Strategjik, me synimin që Udhëheqësit ta miratojnë atë në Samitin e Madridit 2022.

Nga ana tjetër Nisma e “NATO 2030” ka të bëjë me sigurimin që Aleanca të mbetet e gatshme sot për t'u përballur me sfidat e së nesërme. Në dhjetor 2019, udhëheqësit e NATO-s i kërkuan Sekretarit të Përgjithshëm Jens Stoltenberg të kryente një proces



reflektimi largpamës për të forcuar Aleancën. Në qershor 2020, Sekretari i Përgjithshëm paraqiti prioritetet e tij për NATO-n 2030: Të sigurohet që NATO të mbetet e fortë ushtarakisht, të bëhet edhe më e fortë politikisht dhe të marrë një qasje më globale. Në Samitin e Brukselit të vitit 2021, aleatët ranë dakord për agjendën ambicioze të NATO-s 2030, e cila përfshinte vendimin për përditësimin e Konceptit Strategjik. Kjo pasi hera e fundit që liderët aleatë kanë miratuar një Koncept Strategjik është ai në Samitin e NATO-s, të vitit 2010 në Lisbonë, Portugal. Koncepti aktual Strategjik i vitit 2010 i hapi rrugën Aleancës për të modernizuar aftësinë e saj për të kryer misionin e saj kryesor të mbrojtjes kolektive, menaxhimit të krizave dhe sigurisë bashkëpunuese, duke vazhduar të promovojë stabilitetin ndërkombëtar. Ai u kërkoi aleatëve të investonin në aftësitë kryesore për të përballuar kërcënimet në zhvillim, ofroi mundësi të reja për dialog dhe bashkëpunim me vendet partnere në mbarë botën dhe mbajti me sukses derën e hapur për anëtarësimin në NATO për demokracitë evropiane. Koncepti Strategjik i 2010-ës ka ndihmuar në udhëheqjen e NATO-s përmes shumë sfidave gjatë dekadës së fundit.

## Konceptet strategjike, Koncepti Strategjik 2010

Koncepti Strategjik përcakton strategjinë e Aleancës, përshkruan qëllimin dhe natyrën e qëndrueshme të NATO-s, detyrat e saj themelore të sigurisë dhe sfidat dhe mundësitë me të cilat përballlet në një mjedis sigurie në ndryshim.

Ai gjithashtu specifikon elementet e qasjes së Aleancës ndaj sigurisë dhe jep udhëzime për përshtatjen e saj politike dhe ushtarake.

Ndërkohë që konceptet strategjike e pajisin Aleancën për sfidat e sigurisë dhe e drejtojnë zhvillimin e saj të ardhshëm politik dhe ushtarak, ata përsërisin qëllimin dhe natyrën e qëndrueshme të NATO-s dhe detyrat e saj themelore të sigurisë. Por konceptet strategjike rinovohen për të marrë parasysh ndryshimet në mjedisin global të sigurisë dhe për të siguruar që Aleanca është e përgatitur siç duhet për të ekzekutuar detyrat e saj kryesore, duke e bërë transformimin në kuptimin e gjerë të termit, një tipar të përhershëm të Organizatës.

Koncepti aktual, Koncepti Strategjik i vitit 2010 “Angazhimi aktiv, mbrojtja moderne”, është një deklaratë shumë e qartë dhe e vendosur mbi detyrat dhe parimet thelbësore të NATO-s, vlerat e saj, mjedisin në zhvillim të sigurisë dhe objektivat strategjike të Aleancës. Pasi e përshkruan NATO-n si “një komunitet unik vlerash të përkushtuar ndaj parimeve të lirisë individuale, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës”, koncepti aktual paraqet tre detyrat thelbësore të NATO-s: mbrojtjen kolektive, menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese. Ai gjithashtu thekson solidaritetin e Aleancës, rëndësinë e konsultimit transatlantik dhe nevojën për t'u përfshirë në një proces të vazhdueshëm reformash.

Dokumenti më pas përshkruan mjedisin e sigurisë të vitit 2010 dhe identifikon aftësitë dhe politikën e nevojshme për të siguruar që parandalimi dhe mbrojtja e NATO-s, si dhe aftësitë



e menaxhimit të krizave, të jenë të pajisura për t'u përballur me kërcënimet e sotme. Këto kërcënime përfshijnë, për shembull, përhapjen e raketave balistike dhe armëve bërthamore, terrorizmin, sulmet kibernetike dhe problemet themelore mjedisore. Koncepti Strategjik pohon gjithashtu se si NATO synon të promovojë sigurinë ndërkombëtare përmes bashkëpunimit. Ai do ta bëjë këtë duke përforcuar përpjekjet për kontrollin e armëve, çarmatimin dhe mospërhapjen, duke theksuar politikën e dyerve të hapura të NATO-s për të gjitha vendet evropiane dhe duke rritur ndjeshëm partneritetet e saj në kuptimin e gjerë të termit. Gjithashtu, ajo pohon se NATO do të vazhdojë procesin e saj të reformës dhe transformimit.

## Hartuesit dhe vendimmarrësit që qëndrojnë pas strategjive

Me kalimin e kohës dhe që nga viti 1949, procesi i vendimmarrjes në lidhje me Konceptin Strategjik ka evoluar, por një veçori konstante është se ata janë miratuar gjithmonë nga aleatët mbi bazën e konsensusit. Këshilli i Atlantikut të Veriut (NAC) është autoriteti përgjegjës për miratimin e dokumenteve strategjike të Aleancës. Konceptet më të fundit Strategjike janë miratuar në takimet e NAC në nivel të Kryetarëve të Shteteve dhe Qeverive gjatë Samitit të NATO-s. Nga shtatë Konceptet Strategjike të nxjerra nga NATO që nga viti 1949, të gjitha u miratuan nga NAC, me përjashtim të MC 14/3.

I lëshuar në vitin 1968, MC 14/3 u miratua nga Komiteti i atëhershëm i Planifikimit të Mbrojtjes (DPC), i cili kishte të njëjtin autoritet si NAC në fushën e tij të përgjegjësisë. Pas tërheqjes së Francës nga struktura e integruar ushtarake në vitin 1966, u vendos që përgjegjësia për të gjitha çështjet e mbrojtjes në të cilat Franca nuk mori pjesë, t'i jepej DPC, në të cilën Franca nuk ishte anëtare. Megjithatë, menjëherë pasi Franca vendosi të marrë pjesë plotësisht në strukturat ushtarake të NATO-s (prill 2009), DPC u shpërbë gjatë një rishikimi të madh të komiteteve të NATO-s,

qershor 2010, i cili synonte të fuste më shumë fleksibilitet dhe efikasitet në procedurat e punës.

Përpara arritjes në NAC, zhvillohen disa faza konsultimi, angazhimi, hartimi dhe negociimi. Është interesante se gjatë Luftës së Ftohtë, Konceptet Strategjike u hartuan kryesisht nga ushtria për miratim nga autoritetet politike të Aleancës. Ato ishin dokumente të klasifikuara me referenca ushtarake (MC). Që nga fundi i Luftës së Ftohtë, autoritetet politike kanë qenë në krye, duke u mbështetur në këshillat e ushtrisë. Ky ndryshim rrjedh nga fakti se që nga viti 1999, NATO ka miratuar një përkufizim më të gjerë të sigurisë, ku dialogu dhe bashkëpunimi janë pjesë integrale e të menduarit strategjik të NATO-s. Përveç kësaj, Konceptet Strategjike të 1991, 1999 dhe 2010 ishin dokumente të paklasifikuara dhe u publikuan për publikun, siç do të jetë Koncepti Strategjik i 2022-ës.

Risia e shtuar e Konceptit Strategjik të vitit 2010 ishte rëndësia që i është dhënë procesit të prodhimit të dokumentit. Kjo u perceptua si një mundësi për të ndërtuar mirëkuptim dhe mbështetje midis zonave të shumta elektorale dhe palëve të interesuara, në mënyrë që të riangazhohen aleatët e NATO-s ndaj parimeve, roleve dhe politikave thelbësore të rinovuara të Aleancës. Gjithashtu, debati u zgjerua për të ftuar publikun e interesuar, si dhe ekspertët për të kontribuar.

Për më tepër, ishte hera e parë që një Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s nisi dhe drejtoi debatin. Ai caktoi një grup ekspertësh të nivelit të lartë, raporti i të cilëve “NATO 2020: Mbrojtje e Siguruar; Angazhimi Dinamik” udhëhoqi debatin, përpara se të konsultoheshin përfundimisht me përfaqësuesit e aleatëve dhe të hartoheshin dokumenti përpara negociatave përfundimtare dhe miratimit zyrtar në Samitin e 2010-ës në Portugal.

Në Samitin e Brukselit të vitit 2021, krerët e shteteve dhe qeverive



të NATO-s miratuan axhendën e NATO-s 2030, një sërë masash konkrete për të nxitur përshtatjen e NATO-s dhe për të siguruar që Aleanca të mund të përshtatet me një realitet të ri të rritjes së konkurrencës globale. Një nga vendimet e rëndësishme që liderët aleatë morën nën NATO 2030 ishte të ftonin Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg për të udhëhequr procesin e zhvillimit të Konceptit Strategjik 2022. Që atëherë, Sekretari i Përgjithshëm ka iniciuar konsultime dhe aktivitete të angazhimit të brendshëm dhe të jashtëm. Këtu përfshihen përfaqësues të aleatëve, zyrtarë nga kryeqytetet, si dhe komunitetet e ekspertëve, vendet partnere dhe organizata të tjera ndërkombëtare, por edhe të rinjtë, shoqëria civile dhe sektori privat. Pas kësaj faze konsultimesh dhe angazhimi, aleatët do të negociojnë një tekst të bazuar në propozimet e Sekretarit të Përgjithshëm, me synimin që Udhëheqësit të miratojnë Konceptin e ri Strategjik në Samitin e Madridit 2022.

### Dokumentet strategjike të NATO-s që nga viti 1949

Në përgjithësi, që nga lindja e NATO-s, ka pasur tre periudha të dallueshme brenda të cilave mendimi strategjik i NATO-s ka evoluar: periudha e Luftës së Ftohtë; periudha e menjëhershme e pas Luftës së Ftohtë; dhe mjedisi i sigurisë që nga 11 shtatori.

Mund të thuhet se nga viti 1949 deri në vitin 1991, strategjia e NATO-s u karakterizua kryesisht nga mbrojtja dhe parandalimi, megjithëse me vëmendje në rritje ndaj dialogut dhe detentimit për dy dekadat e fundit të kësaj periudhe. Nga viti 1991 u miratua një qasje më e gjerë ku nocionet e bashkëpunimit dhe sigurisë plotësuan konceptet bazë të parandalimit dhe mbrojtjes.

Nga viti 1949 deri në fund të Luftës së Ftohtë, ka pasur katër Koncepte Strategjike, të shoqëruara me dokumente që parashikonin masat që ushtria të zbatonte Konceptin Strategjik të titulluar Udhëzime Strategjike; Modeli më efektiv i fuqisë ushtarake të NATO-s për vitet e ardhshme; Masat për zbatimin e Konceptit Strategjik. Në periudhën e menjëhershme të pas Luftës së Ftohtë, u publikuan dy Koncepte Strategjike të paklasifikuara, të plotësuar me dokumente të klasifikuara ushtarake (Direktiva MC për Zbatimin Ushtarak të Konceptit Strategjik të Aleancës dhe Udhëzuesi MC për Zbatimin Ushtarak të Strategjisë së Aleancës). Që nga sulmet terroriste të 11 shtatorit, mendimi ushtarak, burimet dhe energjia e NATO-s i kanë kushtuar vëmendje më të madhe luftës kundër terrorizmit, përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë, luftës hibride dhe teknologjive në zhvillim dhe përçarës; NATO angazhoi trupa përtej zonës Euro-Atlantike dhe arriti një anëtarësim prej 30 anëtarësh. Deri më tani, NATO ka hartuar Konceptin Strategjik të vitit 2010, shoqëruar nga Udhëzuesi i Komitetit Ushtarak MC 400/3, mars 2012; Aleanca është në procesin e prodhimit të një Koncepti të ri Strategjik në funksion të miratimit të tij në Samitin e Madridit në 2022.

### Nga viti 1949 deri në fund të Luftës së Ftohtë

Nga viti 1949 deri në vitin 1991,



marrëdhëniet ndërkombëtare u dominuan nga konfrontimi bipolar midis Lindjes dhe Perëndimit. Theksi ishte më shumë te tensioni dhe konfrontimi sesa te dialogu dhe bashkëpunimi. Kjo çoi në një garë armësh shpesh të rrezikshme dhe të shtrenjtë. Siç u përmend më lart, gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë katër Koncepte Strategjike. Përveç kësaj, dy raporte kyçe u botuan gjithashtu gjatë këtyre katër dekadave: Raporti i Komitetit të Tre (dhjetor 1956) dhe Raporti Harmel (dhjetor 1967). Të dy dokumentet i vendosën Konceptet Strategjike në një kuadër më të gjerë duke theksuar çështje që kishin ndikim në mjedisin brenda të cilit u interpretuan Konceptet Strategjike.

### Koncepti i parë Strategjik i NATO-s

NATO filloi të prodhojë dokumente strategjike që në tetor 1949. Dokumenti i parë strategjik i NATO-s që u miratua nga NAC ishte "Koncepti Strategjik për Mbrojtjen e Zonës së Atlantikut të Veriut" (DC 6/1), 6 janar 1950, i pari Koncept strategjik i Aleancës.

DC 6/1 ofroi një koncept të

inferioriteti numerik për sa i përket burimeve ushtarake kundrejt BRSS, si dhe mbështetja në aftësitë bërthamore të SHBA-së. DC 6/1 deklaroi se Aleanca duhet të "sigurojë aftësinë për të kryer bombardime strategjike menjëherë me të gjitha mjetet e mundshme me të gjitha llojet e armëve, pa përjashtim".

Megjithëse DC 6/1 ishte mjaft i detajuar, nevojiteshin më shumë udhëzime për t'u përdorur nga pesë Grupet e Planifikimit Rajonal që ekzistonin në atë kohë. Si rrjedhojë, dokumenti i Udhëzuesit Strategjik (SG 13/16) iu dërgua Grupeve të Planifikimit Rajonal më 6 janar 1950. Me titull "Udhëzime Strategjike për Planifikimin Rajonal të Atlantikut të Veriut", SG 13/16 u miratua zyrtarisht nga Komiteti Ushtarak më 28 Mars 1950 si MC 14.

MC 14 u mundësoi Grupeve të Planifikimit Rajonal të zhvillonin plane të detajuara të mbrojtjes për të përmbushur situatat e paparashikuara deri në korrik 1954, datë deri në të cilën Aleanca synonte të kishte një forcë të besueshme mbrojtëse. Objektivat kryesore të saj ishin të "bindte BRSS se lufta nuk paguan, dhe nëse lufta ndodh, për të siguruar një mbrojtje të suksesshme"



përgjithshëm strategjik për Aleancën. Dokumenti theksonte se funksioni kryesor i NATO-s ishte të pengonte agresionin dhe se forcat e NATO-s do të angazhoheshin vetëm nëse ky funksion parësor dështonte dhe fillonte një sulm. Komplementariteti ndërmjet anëtarëve dhe standardizimi ishin gjithashtu elementë kyç të këtij drafti. Kontributi i çdo anëtarë në mbrojtje duhet të jetë në përpjesëtim me kapacitetin e tij, ekonomik, industrial, gjeografik, ushtarak, dhe masat bashkëpunuese do të vendoseshin nga NATO për të siguruar përdorimin optimal të burimeve. U theksua

të zonës së NATO-s.

Paralelisht, SG 13/16 po përdorej gjithashtu nga Grupet e Planifikimit Rajonal si bazë për plane të mëtejshme, më gjithëpërfshirëse të mbrojtjes. Këto plane u konsoliduan në "Planin Afatmesëm të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut" (DC 13), i cili u miratua nga Komiteti i Mbrojtjes më 1 prill 1950, vetëm një vit pas nënshkrimit të Traktatit të Uashingtonit.

Strategjia e NATO-s përmbahej efektivisht në tre dokumente bazë: DC 6/1 që parashtron konceptin e përgjithshëm strategjik; MC 14/1 i

cili ka ofruar udhëzime strategjike më specifike për përdorim në planifikimin e mbrojtjes; dhe DC 13 i cili përfshinte të dyja këto aspekte si dhe planifikim të konsiderueshëm të detajuar rajonal.

### Lufta koreane dhe Koncepti i dytë Strategjik i NATO-s

Pushtimi i Koresë së Jugut nga divizionet e Koresë së Veriut më 25 qershor 1950 pati një ndikim të menjëhershëm në NATO dhe të menduarit e saj strategjik. Ai solli në vend kuptimin se NATO-s i duhej të adresonte urgjentisht dy çështje themelore: efektivitetin e strukturave ushtarake të NATO-s dhe fuqinë e forcave të NATO-s.

Më 26 shtator 1950, Këshilli i Atlantikut të Veriut (NAC) miratoi krijimin e një force të integruar ushtarake nën komandën e centralizuar; më 19 dhjetor 1950, NAC kërkoi emërimin e gjeneralit Dwight D. Eisenhower si Komandantin e parë Suprem të Aleatëve të NATO-s, Evropë (SACEUR); në janar 1951, nga Hotel Astoria në Paris, aleatët po punonin tashmë për të vendosur Shtabin Suprem, Forcat Aleate, Evropë (SHAPE) dhe më 2 prill 1951, u aktivizua selia e re SHAPE. U zbatuan ndryshime të tjera strukturore, përfshirë heqjen e tre Grupeve të Planifikimit Rajonal Evropian dhe zëvendësimin në vitin 1952 të Grupit të Planifikimit Rajonal të Oqeanit të Atlantikut të Veriut nga Komanda Aleate Atlantik (SACLANT), duke lënë në ekzistencë vetëm Grupin e Planifikimit Rajonal Kanada-SHBA.

Këto ndryshime strukturore, së bashku me pranimin e Greqisë dhe Turqisë, duhej të pasqyroheshin në Konceptin Strategjik. Kjo çoi në hartimin e Konceptit të dytë Strategjik të NATO-s: "Koncepti Strategjik për Mbrojtjen e Zonës së Atlantikut të Veriut", i cili u miratua nga NAC më 3 dhjetor 1952 (MC 3/5(Final)). Koncepti i ri Strategjik respektoi parimet thelbësore të përshkruara në DC 6/1 dhe, në këtë kuptim, nuk ndryshonte thelbësisht nga ky dokument.

Rrjedhimisht, udhëzimi strategjik gjithashtu kishte nevojë për përditësim. MC 14 u rishikua dhe u rishikua tërësisht në mënyrë që të përfshinte informacionin që ishte përfshirë më parë në DC 13. MC 14 dhe DC 13 u bënë një dokument: "Udhëzime Strategjike" (MC 14/1) miratuar nga NAC në 15-18 Dhjetor 1952 Takimi Ministror në Par-

is. Ishte një dokument gjithëpërfshirës, i cili thoshte se qëllimi i përgjithshëm strategjik i NATO-s ishte "të siguronte mbrojtjen e zonës së NATO-s dhe të shkatërronte vullnetin dhe aftësinë e Bashkimit Sovjetik dhe satelitëve të tij për të bërë luftë...". NATO do ta bënte këtë duke kryer fillimisht një ofensivë ajrore dhe, paralelisht, duke kryer operacione ajrore, tokësore dhe detare. Sulmet ajrore aleate do të përdornin "të gjitha llojet e armëve".

Kishte një çështje tjetër që ngriti pushtimi korean, por u trajtua vetëm vite më vonë: nevoja që NATO të angazhohej në një "strategji përpara", që do të thoshte se NATO dëshironte të vendoste mbrojtjen e saj sa më larg në lindje në Evropë, sa më afër të mundej, Perdes së Hekurt. Kjo menjëherë ngriti çështjen delikate të rolit të Gjermanisë në një angazhim të tillë. Kjo çështje nuk u zgjidh deri në vitin 1954 kur NATO ftoi Republikën Federale të Gjermanisë për t'u bërë anëtare, gjë që e bëri efektivisht më 6 maj 1955.

### "Një pamje e re"

Ndërkohë, ndërsa çështjet strukturore kishin ecur përpara, mbetej problem fuqia e forcave të NATO-s. Në takimin e tij në Lisbonë, në shkurt 1952, NAC vendosi objektiva forcash shumë ambicioze që rezultuan të ishin joreale financiarisht dhe politikisht. Si pasojë, Shtetet e Bashkuara, nën udhëheqjen e ish-SACEUR të NATO-s, Dwight D. Eisenhower, vendosën të zhvendosin theksin e politikës së tyre të mbrojtjes në varësi më të madhe nga përdorimi i armëve bërthamore. Kjo politikë "New Look" ofroi efektivitet më të madh ushtarak pa pasur nevojë të shpenzonte më shumë për mbrojtjen (NSC 162/2, 30 tetor 1953).

Megjithatë, edhe pse aludohet në dokumentet strategjike, armët bërthamore nuk ishin integruar ende në strategjinë e NATO-s. SACEUR Matthew B. Ridgway deklaroi në një raport se ky integrim do të nënkuptonte rritje në vend të uljeve të niveleve të forcës. Pasardhësi i tij, gjenerali Alfred Gruenther, krijoi një "Grup të Qasjes së Re" në SHAPE në gusht 1953 për të shqyrtuar këtë çështje. Ndërkohë, Shtetet e Bashkuara, së bashku me një numër anëtarësh evropianë, kërkuan integrimin e plotë të politikës bërthamore në strategjinë e NATO-s.

Vijon në numrin e ardhshëm

ANJEZA MUSOLLARI  
Shef i Sektorit të Botimeve

Liderët bëhen të mëdhenj, jo për shkak të fuqisë së tyre por për shkak të aftësisë së tyre për t'i fuqizuar të tjerët - John Maxwell

Lidershipi ose udhëheqja është proces i ndikimit të një individi mbi një grup të caktuar njerëzish, në arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Me këtë nënkuptohet krijimi i raporteve reciproke mes liderit dhe grupit duke ndikuar realizimin e synimeve të një organizate nëpërmjet veprimeve të përbashkëta. Për një organizatë, leadershipi është shumë i rëndësishëm kur vjen puna tek procesi i organizimit dhe menaxhimit të situatave, zhvillimit apo mbarëvajtjes së punës në atë organizatë. Një lider duhet të jetë vizionar, të ketë për vizion arritjen e qëllimeve të përbashkëta por edhe të jetë i hapur ndaj grupit (pasuesve të tij) dhe të pranojë edhe pikëpamjet e pjesëtarëve të grupit. Procesi i leadershipit nuk duhet të përjashtojë as edhe një anëtar të grupit për të shfaqur vizionet dhe mënyrën e tij të realizimit të qëllimeve.

Në një punë ideale, leadershipi është i nevojshëm thjeshtë sepse njerëzit e dinë saktësisht se çfarë duhet të bëjnë dhe të bëjnë gjithçka mirë për të parën herë. Leadershipi dhe hierarkia janë të nevojshme për t' i përqendruar njerëzit në atë që duhet bërë dhe prandaj ata kanë nevojë për një person ose disa persona, që në fakt mund t'ua tregojnë të tjerëve rrugën apo t'ua japin direktiva se ku t' i fokusojnë përpjekjet e tyre, çka të përmirësojnë.

Secili njeri do të mund të punonte individualisht dhe mbase gjërat do të shkonin mirë, mirëpo leadershipi shërben edhe për t' i motivuar të tjerët dhe sidomos nëse është duke u punuar në diçka që është shumë më e ndërlikuar, më e madhe, të cilën nuk mund ta menaxhojë një person i vetëm. Prandaj, nevojitet dikush që shpjegon se pse njerëzit duhet të kryejnë një punë të caktuar dhe pse ajo punë është e rëndësishme. Shumë njerëz kur shkojnë në punë, nuk ia kanë idenë se pse janë duke e bërë atë punë, kështu duhet dikush t'ua rikujtojë atyre pse puna që po bëjnë është në të vërtetë e rëndësishme për të arritur objektivin e përgjithshëm të asaj që janë duke bërë.

Ndër cilësitë e një lideri të mirë në punë konsiderohen komunikimi i ideve, dëshira për të punuar me njerëz dhe të qenit i besueshëm.

Ndër cilësitë e para është të punohet shumë. Duhet të punoni shumë, edhe më shumë se njerëzit që ju rrethojnë. Cilësi e dytë është të jenë në gjendje të komunikojnë idetë, e treta është të pëlqehen. Ata gjithnjë duhet të jenë në kontakt me njerëz, duhet t' i bindin se ata janë personi i duhur për t' i udhëhequr sepse janë vetë njerëzit ata që e zgjedhin liderin e tyre. Lideri nuk emërohet, njerëzit e zgjedhin atë. E që ata t'ju zgjedhin për lider të tyre, ju duhet të jeni në gjendje të komunikoni me ta dhe më e rëndësishmja është të jeni të besueshëm. Duhet t' i mbani të gjitha premtimet tuaja por gjithashtu t' u tregoni njerëzve rregulla të qarta dhe atë që prisni prej tyre.

Lidershipi mund të definohet si af-

# Lidershipi, ndikimi në arritjen e qëllimeve të përbashkëta



tësi e individit për të ndikuar te njerëzit e tjerë, që ata të bashkëpunojnë dhe të kontribuojnë për përpjekjet e orientuara në realizimin e qëllimeve të organizatës. Leadershipi paraqet ushtrimin e autoritetit duke drejtuar punën e të tjerëve. Liderët janë vizionarë dhe frymëzojnë të tjerët të veprojnë me integritet, janë autentik dhe japin rezultate duke u karakterizuar e gjitha me një lider efektiv. Liderët duhet të kenë talent në tërheqjen, motivimin dhe mbajtjen e njerëzve kompetent dhe të përkushtuar. Definicioni më i thjeshtë që mund të shpjegojë leadershipin është se ky është proces i ndikimit në grupin drejt arritjes së qëllimeve. Disa nga definicionet e tjera nga autorë të ndryshëm janë: leadershipi është proces i ndikimit të aktiviteteve të një grupi të organizuar drejt realizimit të objektivave; leadershipi është proces që i motivon njerëzit që të punojnë së bashku për të arritur gjëra të mëdha; leadershipi është proces ku një individ ndikon në një grup të caktuar për të arritur qëllimin.

Teoria e Njeriut të Madh ka evoluar rreth mesit të shekullit të 19-të. Edhe pse askush nuk ishte në gjendje të identifikojë me ndonjë term shkencor se cilës karakteristikë njerëzore ose kombinim i përkiste ai ishte përgjegjës për identifikimin e udhëheqësve të mëdhenj. Gjithkush e kuptoi se ashtu siç sugjeron emri, vetëm një njeri mund të ketë karakteristikat e një udhëheqësi të madh. Teoria e Njeriut të Madh supozon se tiparet e udhëheqësve janë thelbësore. Kanë lindur vetëm liderët e mëdhenj. Kjo teori sheh liderë të mëdhenj si ata që janë të destinuar nga lindja për t' u bërë udhëheqës. Për më tepër,

besimi ishte që udhëheqësit e mëdhenj do të ngriheshin kur të përballeshin me situatën e duhur. Teoria u përhap nga Thomas Carlyle, një shkrimtar dhe mësues. Ashtu si ai, teoria e Njeriut të Madh ishte frymëzuar nga studimi i heronjve me influencë. Në librin e tij "Për heronjtë, adhurimin e heroit dhe heroinën në histori", ai krahasoi një koleksion të gjerë të heronjve. Janë disa karakteristika ose cilësi të caktuara që janë jetike për liderët:

- Pasioni, një drejtues vital është një lider i pasionuar, me një sens autentik të qëllimit që shtrihet përtej interesave egoiste. Pra, një lider vital nuk është i motivuar vetëm për të bërë para, por edhe për të bërë ndryshime.

- Motivimi, ky patjetër lidhet me dëshirën e madhe për sukses, ambicien, iniciativën.

- Energjia, një lider vital përshkohet nga një furnizim i pafund me energji që është emituar gjatë ndjekjes së fuqishme të synimit të karrierës jetësore. Kjo do të thotë që lideri vital manifeston këtë energji me mençuri, fizikisht dhe emocionalisht.

- Besimet dhe vlerat, një lider vital jeton me një grup të besimeve dhe vlerave. Së bashku me interesat e liderit, talentin dhe stilet, ata formojnë një markë lideri unik /të veçantë që përcakton se si një person dëshiron të jetë i perceptuar në punë dhe në jetë.

- Suksesi, një lider vital është një lider i suksesshëm, i frytshëm, me ndikim, lider i balancuar dhe i kënaqur, i cili ka mësuar se si të përdoret pushteti dhe ndikimi personal, për të përdorur pushtetin dhe ndikimin personal për të bërë

një kontribut të rëndësishëm për përmirësimin e organizatave, komuniteteve dhe jetës së tij/saj.

Një person që ka karakteristikat e liderit mund të jetë lider në një kontekst kohor dhe hapësinor por në kontekstin tjetër nuk do të zgjidhet si lider, ai dallon nga anëtari mesatar i grupit me karakteristikat që vijojnë: inteligjenca, shpejtësia, mendjemprehtësia, përgjegjësia, iniciativa, këmbëngulësia dhe socializmi. Rezultatet e hulumtimit kanë sjell në pah se individi nuk bëhet lider me vet faktin se i posedon këto tipare, por që këto tipare duhet të jenë relevante për situatën në të cilën lideri funksionon. Kjo do të thotë se leadershipi nuk është gjendje pasive por paraqet rezultat të relacioneve të pandërprera si: marrje e përgjegjësisë dhe dedikim në realizimin e detyrave, realizim të qëllimeve me përkushtim të lartë, guxim në ndërmarrjen e riskut dhe origjinalitet në zgjedhjen e problemeve, nevojë për realizimin e iniciativave në shoqëri, vetëbesim dhe identitet të ndërtuar personal, gatishmëri që të pranohen konsekuencat për vendimet dhe veprimet, gatishmëri për zgjedhjen e problemeve ndër-njerëzore, vullnet që të tolerohen zhgënjimet dhe vonesat, aftësi të ndikohjës në sjelljen e individëve.

Vetëbesimi është karakteristikë që ndihmon një individ të bëhet lider. Vetëbesimi nënkupton zotësinë e sigurisë në kompetencat dhe shkathtësitë individuale, nënkupton ndjenjën e sigurisë në vete dhe besim se mund të realizojë ndryshime në

kontekstin e dhënë (organizatë, komunitet, shoqëri etj.). Leadershipi nënkupton realizimin e ndikimit tek të tjerët ndërsa vetëbesimi i mundëson liderit të jetë i sigurt se orvatjet e tija janë të drejta. Vendosmëria, shumë liderë janë në gjendje të tregojnë vendosmëri, kjo nënkupton dëshirën që të realizohen detyrat. Vendosmëria tregon edhe demonstrimin e dominimit në kohë dhe në situatat kur duhet që të drejtohen vartësit.

Stilet e leadershipit: Lideri i stilit autokratik, Lideri i stilit demokratik, Lideri i stilit Liberal, Lideri i stilit Burokratik, Lideri i stilit Karizmatik.

## Pse na duhen liderët?

Të udhëhequrit është fenomen i përgjithshëm në të gjitha kulturat. Pse është e nevojshme të udhëhequrit? Çfarë nevojash përmbush të udhëhequrit? A kemi me të vërtetë nevojë për liderë? Kështu që ne do ti cekim disa shembuj se pse na duhet neve një lider, kështu për shembull: në botën e biznesit, liderët e rinj mund të ndikojnë në klasifikimin e kredive të firmës, duke ndikuar në besimin e komunitetit financiar. Ndërsa në sektorë të tjerë, në një qytet ose shtet mund të fitojnë ndjesinë e rilindjes dhe optimizmit ose shqetësim të konsiderueshëm kur një lider i ri vjen në pushtet. Mendojmë se të udhëhequrit është i rëndësishëm. Arsyet pse ne kemi nevojë për lider përputhen shumë me funksionet dhe rolet që liderët luajnë dhe me nevojën ose dëshirën për të qenë pjesë e grupit.

# 10 marinat më të fuqishme në botë

Gazeta "Ushtria do të botojë në numrat e ardhshme marinat më të fuqishme në botë"

**T**ajvani ka investuar shumë në modernizimin e aftësive të tij detare. Marina e Tajvanit ka 38 000 personel. Shumica e luftanijeve të saj janë blerë nga Shtetet e Bashkuara. Disa anije luftarake u morën nga vende të tjera, megjithëse Tajvani është i aftë gjithashtu të ndërtojë anijet e veta. Ndërsa Tajvani blen një sasi të konsiderueshme të pajisjeve ushtarake nga Shtetet e Bashkuara, ai gjithashtu ka një industri të gjallë mbrojtëse indigjene.

Marina e Tajvanit ka 4 shkatërrues të klasit "Kee Lung". Këta janë ish-shkatërruesit e klasit amerikan "Kidd". Anijet ishin riparuar dhe përmirësuar, përpara se t'i dorëzoheshin marinës Tajvaneze.

Marina Tajvaneze operon gjithsej 20 fregata. Këto përfshijnë 8 fregata të klasit "Cheng Kung". Këto luftanije janë prodhuar në Tajvan dhe bazohen në klasin Oliver "Hazard Perry" të SHBA-së. Ka 6 fregata të klasit "Chi Yang" (ish-klasi "Knox" në SHBA) dhe 6 fregata të klasit "Knag Ding" (klasi "La Fayette" i ndërtuar në Francë).

Janë gjithsej 10 anije zbrakimi. Këto përfshijnë një "Hsu Hai" të vetme (ish-klasi i SHBA-së "Anchorage") dhe 2 anije të klasit "Chung He" (ish-klasi i SHBA-së "Newport").

Marina Tajvaneze ka vetëm 2 nëndetëse të dobishme të klasit "Hai



## Marina e Tajvanit

Lung". Këto janë varka holandeze të klasit "Zwaardvis", të blera nga Holanda në mesin e viteve 1980.

Aviacioni detar Tajvanez operon 12 avionë patrullimi detar P-3C Orion, të rinovuar dhe


përmirësuar.

Në këtë listë Top 10, marina Tajvaneze konkurroi me marinën indoneziane për pozicionin e 10-të. Edhe pse marina indoneziane ka dyfishin e personelit dhe duk-

shëm më shumë anije luftarake, pjesa më e madhe e flotës së saj është e kufizuar në operacionet bregdetare, ndërsa marina tajvaneze operon një numër më të madh fregatash detare. Një tjetër lojtar i

fuqishëm, që nuk hyri në këtë listë Top 10 ishte marina turke, e cila është gjithashtu e fuqishme dhe ka një flotë të fortë bregdetare, e cila synohet kryesisht të operojë në rajonin e Mesdheut.





Për 40 javë qeverisje në vitin 2021, u realizuan 53 mbledhje të Qeverisë, që kanë sjellë 434 vendime, prej tyre 119 projektligje – numri më i madh ndonjëherë i projektligjeve të miratuara në qeveri brenda vitit. Përveç këtyre arritjeve janë shënuar rritje edhe në cilësi, meqë shumë nga projektligjet janë të bazuara në opinionet e Komisionit të Venecias, që përbën një standard shumë të lartë.



65% më shumë ligje të miratuara në 2021 se sa në 2020, dhe 91% më shumë se në 2019

# Viti 2021, rekord për nga numri i projektligjeve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës

**V**iti 2021 arriti rekord për nga numri i projektligjeve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Për 40 javë qeverisje në vitin 2021, u realizuan 53 mbledhje të Qeverisë, që kanë sjellë 434 vendime, prej tyre 119 projektligje – numri më i madh ndonjëherë i projektligjeve të miratuara në qeveri brenda vitit.

Përveç këtyre arritjeve janë shënuar rritje edhe në cilësi, meqë shumë nga projektligjet janë të bazuara në opinionet e Komisionit të Venecias, që përbën një standard shumë të lartë.

Në 14 vite për të cilat disponohen shënime, viti 2021 ishte viti me numrin, dukshëm më të madh, të projektligjeve që ka miratuar Qeveria. Viti i dytë me radhë ka qenë viti 2008, me 89 projektligje të miratuara.

65% më shumë ligje të miratuara në 2021 se sa në 2020, dhe 91% më shumë se në 2019. Në përgjithësi rreth 50% më shumë se mesatarja vjetore e 13 viteve të fundit.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
MINISTRIA E MBROJTJES

## Presidentja Osmani: Kolonel Tahir Zemaj ishte njeriu që i doli zot vendit

*Në fjalën e saj znj. Osmani tha se kujtimi për ta nuk zbehet, sepse secili në mënyrën e vet, atdheut iu bë shërbëtor. Nëntëmbëdhjetë vite nga vrasja e Heroit të Kosovës, kolonel Tahir Zemajt së bashku me të birin Enisin dhe kushëririn Hasanin. Kujtimi për ta nuk zbehet, sepse*

*secili në mënyrën e vet, atdheut iu bë shërbëtor.*

*Kolonel Zemaj ishte njeriu që i doli zot vendit dhe në historinë e luftës çlirimtare do të kujtohet si strateg i betejës së lavdishme të Loxhës. Mbetet peng zbulimi i vrasjes së tij, si më i rëndësishmi nderim që mund t'i bëhet!*



Kolonel Tahir Zemaj  
28.12.1951 - 04.01.2003



Enis Zemaj  
20.02.1963 - 04.01.2003



Hasan Zemaj  
15.08.1968 - 04.01.2003  
Anëtar i FR të LDK-së, Deputet



Në një periudhë të shkurtër prej 19-20 muajsh u bëmë anëtarë të NATO-s, përfunduam integrimin ushtarak me NATO-n dhe dua të përfitoj nga rasti për t'ju falënderuar, për punën e madhe që përfundoi sot, të gjithëve që morët pjesë dhe mendoj se këtu nuk shoh asnjë që nuk ka marrë pjesë, – ndërsa disa po përgatiteshin këtu, një grup nga ekipi IPT nga Shtabi i Përgjithshëm, nga Ministria, zëvendësi im ishin në Kuvend dhe arritën të realizojnë edhe këtë vit një pjesë të kontratës për modernizimin me mjete të blinduara të lehta dhe mund të themi në fund të vitit se kemi realizuar mbi 98 për qind të buxhetit tonë.



TAKIM ME PUNONJËSIT E MM-SË DHE SHP

# Ministrja Shekerinska: Së bashku kemi arritur sukses historik

**M**inistrja Radmilla Shekerinska, në takim tradicional me punonjësit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Armatës i falënderoi ata për punën e palodhur me rezultate të mëdha, përfshirë anëtarësimin historik në Aleancë dhe procesin e integritimit që përfundoi këtë vit në një kohë rekord.

“Pas dy vitesh të vështira, në të cilat nuk mund të organizonim takime të tilla, sot u inkurajua pak dhe thamë që nëse i organizojmë me të gjitha masat, do të thotë të gjithë ju me maska dhe vetëm unë duke folur pa maskë, menduam se ishte një mënyrë e mirë për të rrumbullakuar jo një, por dy vjet.

Ishin nga njëra anë dy vite shumë të vështira, humbëm njerëz të dashur në institucion, më lejoni të shpreh dhimbjen tonë të përbashkët për jetët e humbura si pasojë e Kovidit si edhe si pasojë e situatave post-Kovid.

Një numër personash kanë dalë në pension, por ne i shohim dhe patëm mundësinë edhe për herë të parë pas shumë kohësh t'i pensionojmë solemnisht.

Nga ana tjetër, pavarësisht dy viteve të vështira, këto janë ndoshta ndër vitet më të suksesshme për mbrojtjen në vendin tonë.

Në një periudhë të shkurtër prej 19-20 muajsh u bëmë anëtarë të NATO-s, përfunduam integrimin ushtarak me NATO-n dhe dua të përfitoj nga rasti për t'ju falënderuar, për punën e madhe që përfundoi sot, të gjithëve që morët pjesë dhe mendoj se këtu nuk shoh asnjë që nuk ka marrë pjesë, – ndërsa disa po përgatiteshin këtu, një grup nga ekipi IPT nga Shtabi i Përgjithshëm, nga Ministria, zëvendësi im ishin në Kuvend dhe arritën të realizojnë edhe këtë vit një pjesë të kontratës për modernizimin me mjete të blinduara të lehta dhe mund të themi në fund të vitit se kemi realizuar mbi 98 për qind të buxhetit tonë.

Urime për përfundimin final, që tregon se kemi mësuar të vrapojmë si në distanca të gjata ashtu edhe në distanca të shkurtra.

Unë me të vërtetë dua t'ju falënderoj për durimin dhe përpjekjen e madhe që keni bërë në këto dy vjet, sepse asgjë nuk funksionoi siç ishim mësuar. Na u desh të ndryshonim të gjitha rregullat, disa nga ato rregulla rezultuan të suksesshme dhe ndoshta



duhet, shpresoj që maskat t'i harrojmë shpejt, e disa nga metodat më efektive të bashkëpunimit, ato mund të na bëhen shprehi.

Thonë se nuk mund të kthesh vetëm tre gjëra në jetë – momentin pasi ka kaluar, fjalën pasi është thënë dhe kohën pasi ka humbur. Nëse mund ta përkufizojmë veten si të suksesshëm në këto dy vite, është se nuk kemi bërë asnjë nga këto gabime. Nuk ia lejuam vetes të humbim momentin as si institucion e as si shtet, momentet që ishin fjalë për fjalë një shans strategjik, historik, nuk humbëm fjalët kot, as brenda shtëpisë, as në publik dhe gjithashtu nuk humbëm kohën kot.

Prandaj edhe kishte rezultate. Dua të them se praktikisht të gjithë ata që morën pjesë në këto procese do të mund të thonë se ishin pjesë e asaj pamjeje të madhe të quajtur sukses strategjik. Unë mendoj se nuk mund t'i shpërblejmë të gjithë, por më besoni sa herë që prezantojmë një dekoratë, çmim të caktuar, të gjithë jemi të shkruar diku në atë histori suksesi.

Pra, më lejoni t'u kërkoj falje të gjithë atyre që qëndruan më gjatë në punë, të tillë kishte shumë, për të thënë se planet duhet të vazhdojnë të jenë ambicioze, sepse ne thamë që në momentin e parë që anëtarësimi

në NATO nuk është qëllimi ynë, pas të cilit do të qëndrojmë të pushojmë, përkundrazi, integrimi ka treguar që kemi ecur edhe më shpejt, por e uroj atë proces dhe jam e bindur që do të vazhdojë.

Në ministri, jam e bindur se deri në fund të mandatit të kësaj qeverie në RVKE, do të arrijmë të vendosim Ligjin për nëpunësit e mbrojtjes dhe falënderoj grupin që vazhdoi punën, këtu në ditët e festave do të mund të punojmë edhe më shumë së bashku, por le të fillojë procesi, sepse kur të nis procesi nuk ka më kthim.

Sipas informacioneve që mora në Kuvend, Ligji për Shërbim me siguri do të mund të miratohet shpejt, por do të shohim, është përtej fuqive tona.

Bëj apel që proceset që kemi nisur për digjitalizimin e proceseve të caktuara, duke filluar nga pagat, me regjistrat personal, e deri te sistemi i prokurimit publik, që realisht të jenë prioriteti juaj. Ministria, ministrja, sekretari i shtetit, Shtabi i Përgjithshëm, ne të gjithë harxhojmë shumë energji dhe kohë për gjëra që duhet të plotësohen teknikisht për të pasur më shumë kohë për t'u marrë me thelbin, përmbajtjen, cilësinë, dhe nëse këto tre procese përfundojnë me sukses në 6 muajt e ardhshëm, jam e bindur

se do të kemi më shumë mençuri dhe më shumë guxim për t'u marrë me shumë probleme që kanë mbetur të pazgjidhura, siç është sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit që është përgjegjësia jonë politike, por edhe në pjesën e inovacionit të PAZHAM, për të vazhduar reformat.

Ministria vazhdon me një buxhet tashmë rekord të lartë – 1.76% të PBB-së dhe kjo është një plus dhe do të mund të rezultojë në të ardhura më të larta dhe shanse më të larta, por ai buxhet do të duhet të njihet dhe shpenzohet dhe ne kemi parë që ndonjëherë është vështirë se si të shpenzoni me cilësi dhe shpejt.

Në këto dy vite jemi bërë më pak të bezdisshëm – Ministria e Mbrojtjes prej vitesh, çdo vit është institucioni më transparent, e reja ishte këtë herë që morëm 100 pikë. Ruajeni këtë sepse buxhetet nuk mund të rriten nëse qytetarët nuk kanë përshtypjen se shpenzohen drejt dhe ndershmërisht.

Përderisa të jemi transparent dhe të tregojmë se këto nuk janë para të shpërdoruara, se nuk keqpërdoren, se këto janë paratë nga të cilat do të fluturojnë helikopterët nesër, ushtria do të ndihmojë, do të ndihmojë në të gjitha situatat, kështu buxheti juaj do të jetë i sigurt.

Në fund Shekerinska uroi një

vit të suksesshëm, mbi të gjitha shëndet për të gjithë, një lloj tjetër avancimi në karrierë, disa nuk janë më këtu, shkojnë jashtë vendit, disa qëndrojnë këtu me kompetenca dhe përgjegjësi të shtuara, dhe ekipi do të jetë në stres edhe më të madh për të qenë më të mirë, më të shpejtë dhe më efikas.

Ky ekip nuk ndërtohet realisht as në bazë të asaj se kush në cilin pozicion ndodhet, as në bazë të asaj se kush ka punuar për sa vite. Dje morëm videon se një nga kolegët tanë më të rinj mori një nder shumë të madh si desk oficer i SHBA-së për të marrë njohjen nga partneri ynë strategjik, edhe pse shpejt ka filluar arsimimin si oficer.

Kjo tregon se vërtet ia vlen të investosh në njerëz dhe se rezultatet shihen shumë shpejt. Por ekipi nuk bazohet nëse atë se dikush është “junior” apo “senior”, nëse dikush ka një pagë më të lartë apo më të ulët, bazohet vetëm në atë se çfarë besimi krijohet në ekip.

Ju falënderoj për besimin që më keni dhënë gjatë gjithë këtyre viteve, që të mundohemi me shumë çështje dhe të krenohemi me shumë suksese dhe shpresoj që këtë besim ua kam kthyer gjithashtu me besim dhe punë nga e cila ishim të gjithë të lumtur dhe të kënaqur së bashku.

# FAN NOLI - Dishepujve iu festohen veç ditëlindje

**U** lind më 6 janar 1882, me emrin Theofanes Stylianos Mavromatis, në fshatin shqipfolës Ibriktepe, në Trakinë Lindore, asokohe vilajeti i Edrenesë. Si disa fshatra të tjerë të asaj krahine të banuar me shqiptarë, qyteza kishte ruajtur me kohë gjuhën, doket dhe traditat e të parëve. Noli e konsideronte fisin e vet me prejardhje nga qyteza e Kolonjës.

I ati, Stilian Gjergj Noli, ishte psalt në kishën ortodokse të fshatit; e ëma, Marie Gollaqi, ishte shtëpiake. Theofani ishte i dyti ndër trembëdhjetë fëmijë, shtatë prej të cilëve vdiqën në foshnjëri. Familja rronte me tokat që kishte në pronësi. Sa që i mitur, Noli hoqi sëmundje të rënda, prandaj shkollën e nisi me vonesë. Nga i ati trashëgoi dashurinë për muzikën kishtarë si dhe për adhurimin e heronjve, veçanërisht kultin e Napoleonit. Në fshatin e lindjes kreu shkollimin fillor greqisht për gjashtë vite, më tej prindërit e dërguan në gjimnazin grek të Edrenesë, ku qëndroi katër vite.

Në vitin 1900 vendosi të shkonte në Greqi, por gjatë qëndrimit në Stamboll u sëmur, qëndroi atje për t'u kuruar e pastaj punoi për ca kohë në një ëmbëltore. Vitin tjetër u nis për në Athinë dhe të njohurit e tij i gjetën vend si nëpunës në një shoqëri belge, e cila kishte koncesionin e tramvajeve me kuaj në qytet. U regjistrua në Fakultetin e Filozofisë në kryeqytetin grek. Më tej, meqë kishte prirje për aktor, punoi si kopist, sufler e aktor me një trupë teatri me të cilën u end nëpër Greqi për gati dy vjet. Gjatë endjeve me trupën shkroi dramën "To ksipnima" ("Zgjimi"), e cila u luajt nga trupa në Pirgos të Peloponezit. Atë periudhë nisi të shkruante skeletin e dramës "Israelitë dhe filistinë". Në fillim të 1903 shkoi në Egjipt, ku gjeti punë si mësues lëvizës greqishteje dhe po atë vit përktheu në greqisht traktatin e Sami Frashërit "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet". Po atje filloi të bjerë në kontakt me veprimtarët e Rilindjes Kombëtare në koloninë shqiptare të Egjiptit, ndër të cilët Thanas Tashko dhe Jani Vruho e ndihmuan të botohej përkthimi; gjithashtu e lidhën me Spiro Dinen, Nikolla Naçon, Shahin Kolonjën e Kristo Luarasin. Qëndroi në Shibin el Kom dhe El Faiyum, ku përpos mësimit të greqishtes që edhe këngëtar i koreve kishtarë. Me Tashkon dhe Vruhon gatiti botimin e së përkohshmes "Shkopi", që botohej në Kairo.

Pas tre vjetësh qëndrimi në Egjipt, në prill 1906 u nis për në Shtetet e Bashkuara, duke kaluar nga Napoli, dhe mbërriti në Nju Jork më 10 maj. Pasi ndenji në Buffalo, ku punoi në një fabrikë të sharrës për



tre muaj, Noli shkoi në Boston. Në gushtin e po atij viti gjeti punë në Filadelfia, por e la pasi Sotir Peci i ofroi të bëhej zëvendës redaktor i së përkohshmes "Kombi".

Me zgjedhjet e mbajtura, më 5 prill 1921, zgjidhet deputet i Kolonisë së Amerikës në legjislaturën e dytë (21 prill 1921 - 30 shtator 1923). Ai shërbeu si ministër i Jashtëm në qeverinë e Xhaferr Ypit, vetëm për pak kohë përpara se të dorëhiqej. Noli ishte kryetar i Partisë Popullore, e majta e asaj kohe, kundrejt Partisë Përparimtare. Përkrah Luigj Gurakuqit dhe Stavro Vinjaut është ndër oratorët më shpotitës të foltores parlamentare. Më 21 nëntor 1923, u shugurua peshkop i Korçës dhe mitropolit i Durrësit në Durrës, ndërsa më 27 dhjetor 1923 u zgjodh deputet i Korçës.

Gjatë Lëvizjes së qershorit 1924 Noli nuk ishte për përmbysjen me forcë që ndodhi; ai u vendos

në krye të saj vetëm si kërkesë e krahut të të rinjve, që shihnin tek ai një njeri me formim perëndimor e amerikan. Qeveria e ligjshme e rikthyer me "Fitoren e Legalitetit", më 24 dhjetor, e dënoi Nolin me vdekje në mungesë. Programi i tij me njëzet pika për modernizimin dhe demokratizimin e Shqipërisë, ndër të cilat edhe reforma agrare, ishte tejet i nxituar e idealist për një vend të prapambetur dhe pa tradita parlamentare. Më vonë Noli i shkroi arsyet e dështimit të tij në një letër që ia drejtonte një mikut të tij anglez "Duke këmbëngulur tek reformat agrare, zgjova zemërimin e aristokracisë çifligare; duke mos i zbatuar reformat, humba mbështetjen e masave fshatare". Ardhja e një delegacioni sovjetik me në krye Arkady Krakovetsky shqetësoi kancelaritë perëndimore deri në atë pikë, sa të mbështesnin ardhjen e Zogut me anë të 106-112 oficerëve të ish-Ushtrisë Perandorake Ruse.

Sipas Këlcyrës në memuaristikën e tij, vërente se lidhjet me Bashkimin Sovjetik ishin munduar ngaherë t'i sendërtonin, por ishte pikërisht kjo lëvizje që duhej të soste. Vepra e parë e Nolit që drama me tre-akte "Israelitë dhe Filistinë", e botuar në Boston 1907. Kjo dramë që shkruar qysh më 1902, bazuar në historinë e Samsonit dhe Dalilës në Dhjatën e Vjetër. Duke ndër të nevojën e besimtarëve për të mbajtur meshë në shqip, përkthen ritualet dhe liturgjinë ortodokse në dy vëllime "Libër e shërbesave të shënta të kishës ortodokse", Boston 1909, dhe "Libre é te krémtevé të mëdha të kishës ortodokse", Boston 1911. Përkthime që ai i çmonte si arritjet më të mëdha të tij. Më 1921 doli vepra e tij madhështore në prozë "Historia e Skënderbeut (Gjergj Kastriotit), mbretit të Shqipërisë 1412-1468", Boston. Në Shqipëri erdhi sërish në fillim të viteve '20. Më 1947 botoi përpunimin që i

● Gjatë Lëvizjes së qershorit 1924 Noli nuk ishte për përmbysjen me forcë që ndodhi; ai u vendos në krye të saj vetëm si kërkesë e krahut të të rinjve, që shihnin tek ai një njeri me formim perëndimor e amerikan. Qeveria e ligjshme e rikthyer me "Fitoren e Legalitetit", më 24 dhjetor, e dënoi Nolin me vdekje në mungesë. Programi i tij me njëzet pika për modernizimin dhe demokratizimin e Shqipërisë, ndër të cilat edhe reforma agrare, ishte tejet i nxituar e idealist për një vend të prapambetur dhe pa tradita parlamentare. Më vonë Noli i shkroi arsyet e dështimit të tij në një letër që ia drejtonte një mikut të tij anglez "Duke këmbëngulur tek reformat agrare, zgjova zemërimin e aristokracisë çifligare; duke mos i zbatuar reformat, humba mbështetjen e masave fshatare".

bëri "George Castrioti Scanderbeg" (1405-1468), New York 1947; që do i shërbente si temë diplome në Universitetin e Bostonit. Tjetër veprë e tij në anglisht "Beethoven dhe Revolucionin francez" (Beethoven and the French revolution) në 117 faqe, e botuar në New York 1947, pasqyrore figurat e mëdha të historisë (Jul Çezari, Jezusi, Skënderbeu dhe Napoleon Bonaparte). Vëllimi me vjersha "Albumi" u botua më 1948. Brenda viteve 1961-1963 botoi dy vjershat e fundit origjinale dhe disa shqipërime vjershash të poetëve të njohur.

Kontributi më i gjerë i Nolit që në fakt ai i stilistit, siç shihet në përkthimet e tij. Bashkë me Faik Konicën mund të vlerësohet si ndër stilistët më të mëdhenj të dialektit Toskë. Afria që kishte me gjuhën e huaja, greqishten, anglishten dhe frëngjishten e aftësoi ta bënte shqipen në një gjuhë të stërholluar dhe elegante, ndonëse folklorike.

# Shqipëria, Lufta e Ftohtë, Traktati i Varshavës dhe baza ushtarake e Pashalimanit



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Buletin me vlera për studiuesin ushtarak

AQFA në këtë fundviti botoi "Buletini Arkivor Ushtarak" me një përmbledhje të dokumenteve që gjenden për Traktatin e Varshavës dhe Luftën e Ftohtë në Shqipëri. Botimi i këtij buletini, tashmë të mirëpritur nga studiuesit ushtarak dhe civil, ka sjellë dokumentet që janë pjesë e fondeve të Arkivit Qendror të Forcave të Armatosura, në Ministrinë e Mbrojtjes. Këtë herë bordi i botimit me shumë të drejtë ka publikuar dokumente që përfshijnë një periudhë shumë të veçantë të Luftës së Ftohtë, që lidhet me pjesëmarrjen e Shqipërisë në Traktatin e Varshavës prej vitit 1955-1968.

Lexuesi nëpërmjet dokumenteve që botohen për herë të parë, njihet me të dhëna të nxjerra nga Fondi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë (PPSH) dhe Drejtoria Politike që flasin për Traktatin e Varshavës dhe krijimin e Komandës së Bashkuar të FA-së dhe ndihmës reciproke të shteteve pjesëmarrëse si Shqipëria, Bullgaria, Hungaria, Polonia, Bashkimi Sovjetik (BS), Çekosllovakia dhe Republikës Demokratike Gjermane, si dhe të Traktatit të Miqësisë dhe Bashkëpunimit Reciprok ndërmjet tyre.

Në këtë buletin do të njiheni me Komitetin Qendror të PPSH-së mbi mosmarrëveshjet që kishin lindur midis PK të Bashkimit Sovjetik dhe PK të Kinës, si dhe me mosmarrëveshjet midis Shqipërisë dhe BS për problemin e Bazës Luftarake-Detare të Pashalimanit. Dokumente të tjera paraqesin kursin e afrimit të shtetit shqiptar me Republikën e Kinës.

Buletini pasqyron në mënyrë të detajuar dokumente lidhur me ashpërsimin dhe qëndrimin e shtetit shqiptar ndaj veprimtarisë antishqiptare të N. Hrushovit. Dokumente të tjera pasqyrojnë denoncimin e shtetit shqiptar të Traktatit të Miqësisë me këto vende etj.

Dokumentet pasqyrojnë dhe raportin e MMP, si dhe mbledhjen e Këshillit të Mbrojtjes së bashku me vendimet, si dhe masat për rritjen e mëtejshme të gatishmërisë luftarake të Ushtrisë Popullore të Shqipërisë ndaj një agresioni të mundshëm ajror dhe detar nga forcat ushtarake të Traktatit të Varshavës.

## Në Bazën Ushtarake të Pashalimanit

Në bazën ushtarake të Pashalimanit nga nëntori i vitit 1960, kishte filluar acarimi i marrëdhënieve të efektivit të përbashkët shqiptaro-sovjetik. Ashpërsia e marrëdhënieve dhe ngritja e tensionit kishte filluar në gjysmën e dytë të nëntorit 1960, në ditët e fundit të marsit dhe në fillimet



e majit të vitit 1961. Karakteristikë e tyre ishte se qeveria sovjetike kishte organizuar dhe ndërmarrë sulme kundër qeverisë shqiptare dhe udhëheqjes së partisë. Gjatë nëntorit, delegacioni i PPSH-së, që ishte në Konferencën e 81-të të Partive Komuniste dhe Punëtore në Kremlin nga udhëheqja sovjetike i bëhej shantazh.

Efektivit sovjetik të bazës ushtarake të Pashalimanit iu dha sinjali për të ndërmarrë veprime arbitrare në kundërshtim me marrëveshjet për bazën e përbashkët. Muajt dhjetor, janar, shkurt dhe në gjysmën e parë të marsit 1961, në bazën ushtarake të Vlorës u punua normalisht nga efektivit i përbashkët. Planet e stërvitjes luftarake, siç i vërtetojnë dokumentet, u zbatuan në rregull dhe regjimi operativ i bazës u zhvillua me kualitet megjithëse gabime dhe të meta të zakonshme shfaqeshin nga të dy palët.

Disa ditë para mbledhjes së komitetit politik konsultativ të vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës, në bazën ushtarake të Pashalimanit si me sinjal filluan të acaroheshin, kur këshilltarët dhe instruktorët sovjetikë shkelën rregullat e shërbimit të radës, ndërprejnë stërvitjen luftarake dhe daljen e anijeve në det. Kishte filluar një fushatë e hapur shpifjesh në masën e efektivit sovjetik kundër qëndrimit politik të qeverisë dhe partisë. Nga kronologjia e ngritjes së tensionit në bazën ushtarake të Pashalimanit nuk mund të mos tregohet qartë se miti i ngritjes së tensionit dhe burimi i tij ishte Moskë. Në gjysmën e dytë të marsit 1961 qeveria sovjetike me qëllim që të fabrikonte akuza për të vënë pjesëtarët e Traktatit të Varshavës përpara një situatë false të gjendjes në bazën ushtarake të Pashalimanit dhe të merrte aprovimin e tyre për prishjen e saj, iu dha udhëzime këshilltarëve dhe instruktorëve sovjetikë që të punonin në bazën për acarimin e marrëdhënieve me efektivin shqiptar.

Nga gjithë historiku i ngjarjeve del e qartë se në marrëdhëniet sovjetiko-shqiptare, në bazën ushtarake të Pashalimanit, qeveria sovjetike në këtë bazë gjithnjë kishte parë jo një detachment të fuqishëm luftarak të kampit socialist në pellgun e Mesdheut, por një pikëmbështetje për

shantazhe dhe presione të padrejta dhe pa baza ndaj qeverisë së Shqipërisë.

Duhej të largoheshin ata, sovjetikët

Me largimin e 8 nëndetëseve në bazën e Katelnikov dhe me insistimin që bëri pala sovjetike për të mbajtur në Shqipëri instruktorë sovjetikë në Flotën Luftarake Detare shqiptare, çështja që ishte për t'u zgjidhur nuk u zgjidh, për qëndrimin jo të drejtë të palës sovjetike u ngatërrua dhe më shumë.

Po çfarë u arrit me largimin e 8 nëndetëseve në bazën Katelnikov nga pala sovjetike? Së pari, u dobësua mbrojtja e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe fuqia mbrojtëse e kampit socialist në basenin e Mesdheut; së dyti, u inkurajuan dhe më shumë armiqtë e Republikës Popullore të Shqipërisë në planet e tyre agresive kundër vendit tonë; së treti, u bë ajo që kërkonte Niksoni në bisedimet e tij me udhëheqësit sovjetikë, heqja dorë nga ana sovjetike nga baza lundruese detare e Vlorës si kusht paraprak për të filluar bisedimet rreth likuidimit të bazave amerikane dhe rreth problemit të çarmatimit. U bë pra, në këtë mënyrë edhe një lëshim paraprak i imperializmit për hir të bisedimeve me të. Kuptohet që këto "suksese" sovjetike jo vetëm që nuk e forconin pozitën e sistemit socialist në botë, por e dobësonin atë. Sovjetikët arritën deri aty sa çështjen e largimit të instruktorëve sovjetikë nga grupi i nëndetëseve e quajtën "problem të ri" dhe jo hallkën më të vjetër, më të njohur dhe burimin e të gjithë fërkimeve të ndodhura në bazë.

Për bazën luftarake detare të Pashalimanit dhe mos marrëveshjet e ndodhura, ka shumë dokumente dhe materiale. Në të gjitha këto materiale del qartë se instruktorët sovjetikë, u sollën si komandantë, shkelën dispozitat e karakterit të punës, fyen dinjitetin personal të njerëzve dhe krijuan shkaqe për fërkime. Të evitoheshin fërkimet dhe skandalet duhej tamam të largoheshin ata, sovjetikët. Kjo gjë ishte dhe burimi i mosmarrëveshjeve që lindin në bazë.

Këto qëllime jomiqësore të palës sovjetike nuk mund të realizoheshin.

Në një dokument theksohet se: "Pala shqiptare, duke ruajtur respektin e thellë për njerëzit sovjetikë nuk do t'i lejojë instruktorët e bazës luftarake detare të Pashalimanit që të sillen siç janë sjellë deri me sot brutalisht me dinjitetin tonë nacional. Në bazë të marrëveshjeve që ju keni hedhur poshtë nuk do t'i lejojmë ata as të sillen si zot të anijeve, as si komandantë, as të sigurojnë shërbime të veçanta roje, as të merren me punë agjitative kundër udhëheqjes së Partisë e të shtetit tonë siç janë marrë deri tani një pjesë e tyre dhe as të lidhen direkt, d.m.th. jo nëpërmjet komandës sonë të Flotës me ndërlydhje me mjete radioteknike me jashtë, gjë që është në kundërshtim me të drejtat tona si shtet sovran. Pala jonë edhe në këto kondita që ju me qëllim ecni në rrugën e acarimit të marrëdhënieve midis vendeve tona, nuk ka kundërshtim që të mbahej ndërlydhja teknike midis flotave tona, por jo këtë ta bëjnë persona individë të ndodhur në Shqipëri me cilësinë e instruktorit".

Duke insistuar në tërheqjen e menjëhershme të instruktorëve sovjetikë nga Flota luftarake detare shqiptare, qeveria shqiptare paralajmëroi se mbi këto vija pala jonë do të përpiqet për të vënë në binarët e nevojshëm, sipas marrëveshjeve ekzistuese aktivitetin dhe qëndrimin e mëtejshëm të padëshiruar nga ne të instruktorëve sovjetikë, që ju insistoni të mbani në bazën luftarake detare të Pashalimanit.

## Qëndresa e oficerëve dhe marinarëve shqiptarë

Në janar të vitit 1961, kundëradmiral Hito Çako ngriti në këmbë me alarm luftarak brigadën e ruajtjes së rajonit të ujërave në ishullin e Sazanit dhe garnizonin e ishullit, ndërsa kundëradmirali Abdi Mati i shpalli alarm shtabit dhe organeve të drejtimin të flotës në Pashaliman. Mbi ngritjet në alarm luftarak nuk u informuan këshilltarët dhe komandanti i Brigadës së Nëndetëseve.

Po në muajin janar 1961, RLS e tipit "Lot" në ishullin e Sazanit diktoi në kanal in e Otrantos një grup anijesh të panjohura (deri 20

copë). Por këshilltarët në shtabin e flotiljes dhe komanda e brigadës së nëndetëseve nuk u njoftuan. Në shkurt 1961 përsëri i diktua një grup anijesh të panjohura në kanal in e Otrantos. Por edhe në këtë rast këshilltarët dhe brigada e nëndetëseve nuk u vunë në dijeni. Gjithashtu nuk u mor asnjë masë për rritjen e gatishmërisë luftarake të flotës dhe për zbulim. Oficerët e rojës të grupit shqiptar të nëndetëseve nxjerrin në radë me kokën e tyre, pa lejen e oficerit të rojës të brigadës, anije ndihmuese dhe katera. Vazhdimisht bëhej lundrim i katerëve dhe anijeve të flotës në rajonin e Pashalimanit nëpër poligonet e stërvitjes pa pëlqimin e komandantit të brigadës së nëndetëseve.

Kështu, ish komandanti i flotiljes shqiptare, kundëradmiral Abdi Mati, në fund të vitit 1960 i dha urdhër komandantit të brigadës së nëndetëseve në një formë të ashpër e brutale duke kërkuar që të vihej në punë baza lundruese "Nemçinov" menjëherë dhe pa marrë parasysh motin (në kohë kur frynte erë e fortë, kishte dallgë dhe ishte errësirë).

Në bazën lundruese "Nemçinov", ku ekuipazhi shqiptar ndodhej me cilësinë e nxënësit, dhe anija ishte nën përgjegjësinë dhe drejtimin e ekuipazhit dhe komandantit sovjetik, shërbimi shqiptar i dezurnit shkeli rregullat e shërbimit të anijes. Në anije hynin e dilnin dhe shumë oficerë dhe marinarë shqiptarë, gjë për të cilën komandanti sovjetik nuk vihej në dijeni.

Komandanti i ekuipazhit shqiptar të bazës lundruese "Nemçinov", Kapiteni i Rangut të 2-të Stavri Çika dhe ndihmësi i tij Kapiteni i Rangut të 3-të Jani Bushi, me kokë të tyre japin udhëzime për vendosjen e oficerëve në kabina pa rënë dakord me komandantin sovjetik, ndërsa disa oficerë shqiptarë okupuan arbitrarisht kabinat. Kështu kanë vepruar dhe Kapiteni i Rangut të 3-të Dashamir Ohri, komandanti i nëndetëses S-270 Toger Aleko Pojani, Kapiteni i Rangut të II-të Shezai Kasaj, Kapiteni i I-rë Muharrem Molla, komandant Toger Petrit Pojani, etj.

Duke qenë se arkivi mbart kujtimet e një periudhe të caktuar historike të vendit, krijon dhe një mundësi për të komunikuar pozitivisht me studiuesit dhe me publikun, duke nxjerrë në pah cilësitë morale dhe njerëzore, disiplinën dhe përgatitjen, ndjenjën e fortë që ka karakterizuar pasionin për të bërë një forcë të armatosur për të ecur përpara. Sfidat që qëndrojnë sot për arkivin kërkohen nxitjen e këtij procesi, përdorimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve, duke e kthyer në një qendër dhe burim të njohurive dhe të krijimtarisë të FA-së. Ky rrugëtim i Buletinit Arkivo-Usharak tashmë është i përcaktuar qartë dhe FA-të krenohen me një institucion të tillë.



Ti ke **forcën** që nderon **kombin**  
Interesim i lartë i të rinjve që **duan** të bëhen pjesë  
e **Forcave të Armatosura** në Korçë.

